



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije i Transfere
Ministry of Finance and Transfers

***RAPORTI 100 DITOR I PUNËS SË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
TRANSFEREVE***

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në 100 ditët e para të Qeverisë Kurti, arritjet më të rëndësishme të Ministrisë së Financave dhe Transfereve janë:

- Është bërë përmirësimi i projekt ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin për vitin 2020 në disa aspekte: keq klasifikimet e shpenzimeve ndërmjet shpenzimeve kapitale dhe mallra e shërbime; reduktimi i numrit fiktiv të punëtorëve për 684 pozita; korigjimi i pjesës tekstuale të ligjit; adresimi i obligimeve të papaguara nga organizatat buxhetore.
- Janë ndarë mjete financiare në shumë prej 400 mijë Euro për Ministrinë e Shëndetësisë për parandalimin e situatave të mundshme emergjente për epidemi, dhe pastaj edhe 10 milion euro tjera pas shfaqjes së pandemisë edhe në Kosovë.
- Janë ndarë 500 mijë Euro për Komunat e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me qëllim të përballimit të gjendjes së krijuar nga pandemia. Ky transfer i mjeteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në llogaritë e tri Komunave të Luginës, në Bankën Qendrore të Serbisë është bërë për herë të parë dhe paraqet një moment të ri për Kosovën.
- Është aprovuar vendimi për mbajtjen e çmimeve në kuadër të kornizave ligjore dhe shmangien e çdo lloj keqpërdorimi që rezulton me rritjen arbitrare të çmimeve për të gjitha shoqëritë tregtare gjatë periudhës së pandemisë.
- Është aprovuar vendimi për lirin e përkohshëm nga pagesa e TVSH-së të të gjitha importeve të grurit dhe miellit për prodhimin e bukës dhe produkteve të bukës.
- Me qëllim të lehtësimit të pengesave të amvisërive dhe bizneseve gjatë periudhës së pandemisë janë aprovuar vendimet për shtyerjen e afateve të raportimit, deklarimit dhe pagesës së tatimeve si dhe për pezullimin e aplikimit të kamatës dhe gjobës për mos pagesën e tatimit në pronë, deri më 31 dhjetor 2020.
- Është hapur llogaria e dedikuar e Thesarit për fondet për menaxhimin e situatës së pandemisë, në të cilën, deri më datë 8 Maj 2020 vetëm nga donacionet janë mbledhur mbi 700 mijë euro.
- Është ndaluar tenderimi dhe ka filluar auditimi i jashtëm i programit për blerjen e biletave të udhëtimit pas analizave që rezultuan me parregullsi në prokurim.
- Ka filluar zbatimin nga Dogana i vendimit të Qeverisë për largimin e taksës 100% dhe zëvendësimi me reciprocitetin. Importet nga Serbia nga fillimi i zbatimit të këtyre masave kanë qenë 12.4 milion euro, ndërsa janë eksportuar në Serbi mallra në vlerë 0.7 milion euro.
- Është siguruar financimi prej 102 milion euro, 52 milion euro nga kredia me FMN si dhe 50 milion euro letra me vlera (obligacion 10 vjeçar).
- Janë përbushur pa asnjë vonesë të gjitha obligimet e organizatave buxhetore, duke ju siguruar likuiditetin e duhur dhe ruajtur stabilitetin e përgjithshëm të vendit.
- Janë kursyer 146,961 euro për periudhën 03.02.2020 deri në 23.04.2020 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019.
- Është nënshkruar marrëveshja e grantit me KfW në vlerë prej 6.5 milion euro që ka për qëllim mbështetjen e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore duke rritur kapitalin e saj

garantues, si dhe marrëveshja e grantit në vlerë 7 milion euro që ka për qëllim themelimin e “Fondit të Sfidave të Kosovës – Arsim Profesional dhe Trajnim”.

- Është nënshkruar marrëveshja e grantit me Bashkimin Evropian përmes Bankës Botërore në vlerë prej 9.4 milion euro që ka për qëllim mbështetjen financiare të Projektit për Eficiencë në Energji dhe Energji të Ripërtëritshme, si dhe marrëveshja e grantit në vlerë prej 2.785 milion euro që i dedikohet komunave për zhvillim të aftësive të rinisë.
- Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian për pjesëmarrje të Kosovës në programin “Dogana 2020” dhe “Fiscalis 2020”.
- Është dizajnuar dhe ka filluar të zbatohet Pakoja Fiskale Emergjente, në vlerë totale të 189,650 milion euro, si mbështetje për të tejkaluar situatën e emergjencës shëndetësore. Në kuadër të saj deri më 8 maj 2020, janë paguar:
 - 5,181,034 euro shtesë për dy muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale (100 mijë përfitues nga kjo skemë);
 - 4,880,610 euro shtesë për skemat pensionale dhe sociale me pagesë mujore deri në 100 euro (nga kjo kanë përfituar 162,687 persona);
 - 13,703,360 euro për subvencionim të pagës në vlerë 170 euro për 80,608 punonjës të sektorit privat të prekur nga vendimet e Qeverisë për parandalimin e rrezikut të infektimit;
 - 6,752,119 euro shtesë mbi pagë për 21,518 punonjës të sektorit publik të cilët me vendime të Qeverisë janë ekspozuar me rrezik të shtuar ndaj infektimit gjatë kryerjes së punës së tyre.
- Në kuadër të Pakos Emergjente Fiskale edhe janë regjistruar 11,633 punëtor të ri, përderisa janë deklaruar si të larguar nga puna vetëm 1,459 punëtor. Për të gjithë këta është siguruar mbështetja financiare prej 130 euro për muaj.
- Është formuar dhe ka filluar punën grupi për dizajnimin e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, pako kjo që do jetë në vlerë shumëfish më e madhe se pakoja e parë dhe do të mbuloj nevojat e ekonomisë së Kosovës për rimëkëmbje pas situatës së pandemisë.

1. Përmirësimet në Buxhetin për 2020

- Është bërë adresimi ligjor i keq klasifikimit të shpenzimeve. Nga organizatat buxhetore, shpenzimet e natyrës mallra dhe shërbime janë keq klasifikuar si shpenzime kapitale, prandaj me ligj të buxhetit këto keq klasifikime janë korigjuar dhe janë bartur nga kategoria e shpenzimeve kapitale në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime, edhe atë: 9.3 milionë euro në vitin 2020, 11 milionë euro në vitin 2021 dhe 14.4 milionë euro në vitin 2022. Kjo ka qenë edhe gjetja kryesore dhe rekomandimi i përsëritur nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Shembuj të keq klasifikimeve që janë gjetur janë:
 - Hartimi projekteve dhe konsulencave teknike
 - Procesi i legalizimit
 - Studimi i fizibilitetit për zonat erozive pritë malore
 - Mbikëqyrja profesionale e projekteve kapitale
 - Mirëmbajtja e sistemit kadastral në Kosovë
- Është bërë reduktimi i numrit fiktiv të punëtorëve në nivel qendror për 684 pozita. Për këto pozita nuk ka pasur mbulesë buxhetore, prandaj përmes ligjit të buxhetit është bërë ulja e numrit të aprovuar të vendeve të punës në një nivel më real ose në nivel të mundësive buxhetore.
- Është kërkuar ligjërisht përmes ligjit të buxhetit nga organizatat buxhetore të bëjnë regjistrimin e zotimeve shumëvjeçare.
- Është përmirësuar formati i pjesës tekstuale të ligjit të buxhetit në përputhje me standardet.
- Janë adresuar obligimet e papaguara ku organizatat buxhetore duhet t'i japin prioritet në buxhetim së pari obligimeve të krijuara e tek pastaj të nisin aktivitete të reja nëse kanë hapësirë të lirë fiskale.
- Është kërkuar ligjërisht që:
 - shpronësimi të trajtohet si pjesë e shpenzimeve kapitale në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale;
 - propozimi i projekteve të reja kapitale nga organizatat buxhetore të bëhet në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale;
 - ndarja e projekteve kapitale për komunat nga niveli qendror të bëhet në mënyrë të barabartë dhe me kritere të qarta;
 - alokimi i buxhetit për RTK të bëhet pasi së pari të jenë aprovuar plani dhe raporti i shpenzimeve nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa;
- Ndarjet buxhetore për projektet që financohen nga Klauzola e Investimeve janë përcaktuar në përputhje me pritjet reale për ekzekutim, ku planifikimi i klauzolës nga 122.7 milion euro në vitin 2019 është korigjuar në 76.8 milionë euro në vitin 2020.
- Është bërë bartja e shpenzimeve të krijuara deri në hyrjen në fuqi të ligjit të buxhetit, bazuar në strukturën e kaluar të qeverisë (21 ministri) në strukturën e re (15 ministri), si dhe të gjitha shpenzimet tjera të bëra nën autoritetin e zgjatjes së ndarjeve buxhetore (1-3/12).

2. Vendimet më të Rëndësishme

Propozim-vendimet e MFT të aprovuara në Qeveri:

- Është mundësuar zgjatja e ndarjeve buxhetore për muajin mars (3/12), me qëllim të përmbushjes së pandërprerë të obligimeve deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri për buxhetin, me aprovim të Qeverisë e më pas të Kuvendit.
- Janë udhëzuar ministritë, subjekt i ristrukturimit për mënyrën e funksionimit deri në hyrjen në fuqi të ligjit për buxhetin dhe pas tij, deri në organizimin e ri me rregullore të brendshme.
- Është emëruar Komiteti për Partneritetin Publiko-Privat.
- Është aprovuar në parim Nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Finlandës, si dhe ajo me Mbretërinë e Holandës.
- Është aprovuar Raporti i vlerësimit të përshtatshmërisë së sistemit të financimit të komunave për vitin 2019.
- Është aprovuar Raporti vjetor financiar për vitin 2019
- Është aprovuar korniza afatmesme e shpenzimeve 2021-2023.
- Është aprovuar Programi i borxhit shtetëror 2021-2023.
- Është aprovuar Raporti tremujor financiar për vitin 2020.
- Është aprovuar Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e fuqizimit të sektorit financiar.
- Është aprovuar Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BERZH për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan.
- Është aprovuar Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
- Është aprovuar kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 200 mijë euro si mbështetje financiare për Republikën e Shqipërisë për qëllim të ndihmës në sanimin e dëmeve nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
- Është aprovuar mbështetja financiare për evitimin e dëmeve nga fatkeqësia natyrore në Komunën e Pejës dhe Istogut në shumën prej 433,050 Euro.
- Është aprovuar ndarja e mjeteve në shumën prej 29,809.10 Euro për projektin e GIZ të cilët i kanë mbështetur refugjatët gjatë qëndrimit në parkun inovativ të Biznesit në Prizren, me rastin e tërmetit në Shqipëri.
- Është shfuqizuar vendimi i Qeverisë nr 20/64 i datës 11.09.2018 për aprovimin e Koncept dokumentit për ndryshimin e politikave fiskale dhe bujqësore për prodhimin e duhanit dhe cigareve në Kosovë.
- Me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve të parasë publike për përdorimin e telefonave në Qeverinë e Republikës së Kosovës, është shfuqizuar vendimi i Qeverisë së Kosovës-

Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes nr 05/3 i datës 22.01.2008 si dhe janë pezulluar nenet (2,3,4,5,6,7 dhe 8) të Udhëzimit Administrativ Nr 04/2008 për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës – Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, deri në nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ përkatës nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

- Janë ndarë mjete financiare në shumë prej 400 mijë Euro për Ministrinë e Shëndetësisë për parandalimin e situatave të mundshme emergjente për epidemi, dhe pastaj edhe 10 milion euro tjera pas shfaqjes së pandemisë edhe në Kosovë.
- Është aprovuar mbështetja financiare për Komunën e Preshevës, Komunën e Bujanocit dhe Komunën e Medvegjës në shumë prej 500 mijë Euro me qëllim të përballimit të gjendjes së krijuar nga pandemia. Pas aprovimit të Vendimit në Qeveri janë ndarë mjetet financiare për komunat si vijon: Për Komunën e Preshevës (200,000.00€), për Komunën e Bujanocit (200,000.00€), dhe për komunën e Medvegjës (100,000.00€). Ky transfer i mjeteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në llogaritë e tri Komunave të Luginës, në Bankën Qendrore të Serbisë është bërë për herë të parë dhe paraqet një moment të ri për Kosovën.
- Është aprovuar ri-alokimi i mjeteve në shumën prej 2,499,771.00 Euro në buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nga Projekti “Bashkëfinancim me donator për skemën e granteve bazuar në performancën komunale”, në 19 projekte kapitale në përputhje me 19 marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga MAPL, kryetarët e komunave përkatëse si dhe donator.
- Është aprovuar propozimi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve për rekomandimin e Presidentit të Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime për financimin e projektit për “Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Gjilanit”.
- Është aprovuar propozimi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve për ndryshimin e listës së artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik.

Vendime nga Ministri i Financave dhe Transfereve

- Është themeluar komisioni për vlerësimin e vendimeve të marra nga Ministri i Financave nga data 19.07.2019 deri më 03.02.2020.
- Është themeluar Komisioni për vlerësimin e aktiviteteve të prokurimit të Ministrisë së Financave dhe agjencive të saj ekzekutive nga data 19.08.2019 deri në datën 03.02.2020.
- Është themeluar Grupi Punues për identifikimin e barrierave që ndërlidhen me portin e Durrësit.
- Është aprovuar vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për pagesat e pensioneve të pjesëtarëve të FSK-së në vlerë prej 177,945 euro.

- Është aprovuar vendim për mbajtjen e çmimeve në kuadër të kornizave ligjore dhe shmangien e çdo lloj keqpërdorimi që rezulton me rritjen arbitrare të çmimeve për të gjitha shoqëritë tregtare, veçanërisht për shoqëritë tregtare që ofrojnë shitje të produkteve të konsumit bazik me pakicë dhe shumicë si dhe të produkteve farmaceutike.
- Me qëllim të uljes së rrezikut të infektimit me COVID19 të shtresës së shoqërisë më të rrezikuar, janë pezulluar përkohësisht obligimet e përfituesve të skemave pensionale për paraqitje për aplikim, riaplikim apo seanca mjekësore.
- Me qëllim që të inkurajohet importi i grurit dhe miellit gjatë periudhës së pandemisë, është aprovuar vendimi për lirim të përkohshëm nga pagesa e TVSH-së të të gjitha importeve të grurit dhe miellit për prodhimin e bukës dhe produkteve të bukës. Si rezultat i kësaj u evitua shterja e rezervave të ushqimit bazë dhe u siguroi furnizim i mjaftueshëm me miell dhe prodhime të bukës në të gjithë territorin e Kosovës gjatë periudhës së pandemisë.
- Me qëllim të lehtësimit të pengesave të amvisërive dhe bizneseve gjatë periudhës së pandemisë është aprovuar vendimi:
 - a. për shtyrjen e afatit për lëshimin e faturave të tatimit në pronë, pagesën e kështit të parë për vitin 2020 si dhe shtyrjen e afatit për paraqitjen e ankesave ndaj faturave të tatimit në pronë dhe certifikatave të vlerave të vlerësuara.
 - b. për shtyerjen e afatit për dorëzimin në KKRF të pasqyrave vjetore financiare, pasqyrave financiare të audituara dhe për dorëzimin në ASK dhe KKRF të pasqyrave për pozitën financiare, llogaritë e fitimit dhe humbjeve si dhe informatat shtesë në lidhje me vitin paraardhës kalendarik deri më 30 Qershor.
 - c. për zgjatjen e afatit për dorëzimin e deklaratave, raporteve dhe pagesave të detyrimeve tatimore si dhe trajtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat për rimbursime.
 - d. për zgjatjen deri më 30 Qershor 2020 të afatit për pagesën e tatimeve si: pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e mëdha individuale dhe bizneset e vogla individuale; dhe, pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për korporatat e mëdha dhe korporatat e vogla.
 - e. për shtyrjen e mëtutjeshme të të gjitha deklarimeve tatimore nga data 30 prill deri më datë 15 maj.
 - f. për pezullimin e aplikimit të kamatës dhe gjobës për mos pagesën e tatimit në pronë, deri më 31 dhjetor 2020.

Ngjarje tjera me rëndësi në Ministrinë e Financave dhe Transfereve

- Është hapur llogaria e dedikuar e Thesarit për fondet për menaxhimin e situatës së pandemisë, në të cilën, deri më datë 8 Maj 2020 vetëm nga donacionet janë mbledhur mbi 700 mijë euro.
- Është hapur një kod i veçantë në kuadër të planit kontabël të Thesarit (00099), i cili identifikon të gjitha shpenzimet e bëra nga organizatat buxhetore që lidhen me luftën ndaj

pandemisë COVID19. Kjo rritë transparencën dhe llogaridhënien mbi shpenzimet e fondeve publike.


- Janë mbajtë 5 ankande të letrave me vlerë për 2020.
- Është ndërprerë kontrata për blerjen e biletave të udhëtimit pas analizave që rezultuan me parregullsi në prokurim, duke siguruar kursime të mëtutjeshme në buxhet dhe shmangien e keqpërdorimeve.
- Është lansuar Webfaqja e Thesarit në domain thesari.rks-gov.net për të rritur efikasitetin, shpejtësinë, pavarësinë dhe transparencën në raportim dhe llogaridhënie, por edhe të ndihmojë organizatat e tjera buxhetore dhe palët e interesuara të kanë qasje në njoftime, ankande, legjislacione, procedura, rregullat dhe dokumente tjera të rëndësishme.
- Është dërguar letër te WCO si kundërpërgjigje ndaj letrës që ka dërguar Serbia përmes së cilës është ndal presioni dhe ndikimi i Serbisë për largimin e Kosovës si anëtare e barabartë me shtetet tjera në këtë organizatë.
- Është arritë funksionalizimi i Atasheut Doganor dhe përzgjedhja e përfaqësuesit të Kosovës në këtë Atashe.
- Ka filluar zbatimimi nga Dogana i vendimit të Qeverisë për largimin e taksës 100% dhe zëvendësimi me reciprocitetin. Importet nga Serbia nga fillimi i zbatimit të këtyre masave kanë qenë 12.4 milion euro, ndërsa janë eksportuar në Serbi mallra në vlerë 0.7 milion euro.
- Është siguruar financimi prej 102 milion euro, 52 milion euro nga kredia me FMN si dhe 50 milion euro letra me vlera (obligacion 10 vjeçar).
- Janë përmbushur pa asnjë vonesë të gjitha obligimet e organizatave buxhetore, duke ju siguruar likuiditetin e duhur dhe ruajtur stabilitetin e përgjithshëm të vendit.

3. Kursimet në shpenzime brenda ministrisë

Kursimet e kësaj qeverie për periudhën 03.02.2020 deri në 23.04.2020 arrijnë në 146,961¹ euro në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Më saktësisht, deri në 23.04.2020 kabinetet e ministrave në të gjithë qeverinë kanë shpenzuar 85,710, ndërsa shpenzime e qeverisjes së mëparshme, për të njëjtën periudhë të qeverisjes, arritën vlerën 232.641 euro. Në mënyrë të ngjashme, shpenzimet të kabinetit të ministrit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve arritën në 1,386 euro ndërsa kabineti i kaluar i të njëjtës ministri (Ministria e Financave) ka shpenzuar për të njëjtën periudhë 4,866 euro.

¹ Duke marrë parasysh që disa fatura të kabinetit të mëparshëm (shpenzimet e krijuara para 03.02.2020) janë raportuar si shpenzime të rrjedhura në muajt e ardhshëm (raportuar si shpenzime të derivuara në periudhën 03.02.2020-24.04.2020). Kështu që, vlera reale e kursimeve të vërteta të krijuara nga kjo qeveri është edhe më e lartë se numri i paraqitur më sipër.

Krahisimi te kursimeve të kabinetit të ministrave e kësaj qeverie për periudhën 03.02.2020 deri në 23.04.2020 me të njejtën periudh të vitit 2019



4. Marrëveshjet ndërkombëtare

Marrëveshjet e nënshkruara

- Është nënshkruar marrëveshja e grantit me KfW në vlerë prej 6.5 milion euro që ka për qëllim mbështetjen e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore duke rritur kapitalin e saj garantues.
- Është nënshkruar marrëveshja e grantit me KfW në vlerë prej 7 milion euro që ka për qëllim themelimin e “Fondin e Sfidave të Kosovës – Arsim Profesional dhe Trajnim”.
- Është nënshkruar marrëveshja e grantit me Bashkimin Evropian përmes Bankës Botërore në vlerë prej 9.4 milion euro që ka për qëllim mbështetjen financiare të Projektit për Efiçencë në Energji dhe Energji të Ripërtëritshme.
- Është nënshkruar marrëveshja e grantit me Bashkimin Evropian përmes Bankës Botërore në vlerë prej 2.785 milion euro që i dedikohet komunave për zhvillim të aftësive të rinisë.
- Është nënshkruar marrëveshja e Prokurimit të Përbashkët me Komisionin Evropian për prokurimin e kundërmasave mjekësore.
- Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian për pjesëmarrje të Kosovës në programin “Dogana 2020”.
- Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian për pjesëmarrje të Kosovës në programin “Fiscalis 2020”.
- Është aprovuar financimi për Kosovën nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në vlerë prej 52 milion euro.

Marrëveshjet që do të nënshkruhen

- Është aprovuar kredia prej 100 milion euro për Kosovën nga Komisioni Evropian si rrjedhojë e instrument Macro-Financial Assistance të BE-së. Kjo vlerë duhet të aprovohet edhe nga Këshilli Evropian dhe Parlamenti Evropian.
- Kanë përfunduar negociatat me Bankën Botërore për projektin Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sektorin e Ujit (FLOWS) në vlerë prej 26.1 milion euro ku 25.1 milionë është kredi nga IDA dhe 1 milionë është grant nga WBIF. Ky projekt ka për qëllim përforcimin e kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e sigurisë së ujërave të Kosovës dhe të përmirësojnë sigurinë e ujërave në pellgun lumor të Moravës së Binçës.
- Janë duke u mbajtur negociatat për “Projektin Emergjent COVID-19 për Kosovën” me Bankën Botërore në vlerë prej 48 milionë euro.
- Është aprovuar në agjendë Kredia për Kosovën në vlerë prej 35 milion euro nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB), nga kjo kredi është marrë grant për subvencionimin e interesit.
- Janë duke u finalizuar diskutimet me Bankën për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për kredi për të mbështetur masat e pakos emergjente rreth ndihmës për ndërmarrjet publike dhe kompanitë lokale që ofrojnë shërbime publike.

Gjatë 100 ditëshit të Qeverisë, Ministri i Financave dhe Transfereve ka nënshkruar marrëveshje granti në vlerë totale prej 25,685,000 milion euro dhe marrëveshje kredie në vlerë prej 52 milion euro, kjo e fundit vetëm nga kredia e FMN për situatën me COVID-19.

5. Nisma të reja nga Qeveria për Kuvend, me propozimin e MFT

- Është dërguar për ratifikim marrëveshja financiare ndërkombëtare me Bankën Botërore për rritjen e kapitalit të fondit për garantimin e kredive.
- Është dërguar në Kuvend vendimi i Qeverisë për rishikim të përkohshëm të rregullave fiskale me qëllim të ballafaqimit me situatën e pandemisë.

Megjithatë, Kuvendi nuk ka proceduar më tutje këto dokumente të rëndësishme, të cilat paraqesin kufizim për potencialin e ekzekutivit për t’u përballur në mënyrë sa më të suksesshme me luftimin e pandemisë si dhe ruajtjes së shëndetit të ekonomisë.

6. Pakoja Emergjente Fiskale

Më 30 mars 2020, u aprovua Pakoja Emergjente Fiskale, që përmban 15 masa përmes të cilave u siguroa mbështetje financiare për të gjithë akterët e prekur nga situata e emergjencës shëndetësore.

Pakoja Emergjente Fiskale është në vlerë totale 189,650,000 euro, ndërsa më shumë se gjysma e kësaj vlere (60%) i dedikohet sektorit privat, dhe pjesa tjetër sektorit publik dhe mirëqenies sociale.

Kategoria	Si % e totalit të Pakos	Në vlerë totale në euro
Spektori Publik	26%	50,000,000
Spektori Privat	60%	114,000,000
Mirëqenie Sociale	14%	25,650,000
	100%	189,650,000

Nga totali i 114 milion euro që i dedikohen sektorit privat, 94 milion prej tyre janë grante dhe subvencione ndërsa 20 milion për likuiditet, ku edhe një pjesë e kësaj shume është për subvencionim të interesit.

Sektori Privat		
Kategoria	Si % e totalit	Në vlerë totale në euro
Shpenzime për paga	54%	62,000,000
Subvencionimi I qirasë	11%	12,000,000
Likuiditet	18%	20,000,000
Grante	18%	20,000,000
	100%	114,000,000

6.1. Masa 1 & 2

Nga kjo pako fillimisht kanë përfituar shtresa më e varfër e shoqërisë, familjet të cilat mbijetojnë vetëm nga të ardhurat e asistencës sociale. Në këtë grup janë rreth 25 mijë familje me rreth 100 mijë anëtar për të cilët, gjatë periudhës së pandemisë, është siguruar pagesa e dyfishtë e asistencës sociale dhe atë për tre muaj. Për këto familje deri më tani janë paguar asistencë sociale e dyfishtë për dy muaj: mars dhe prill, dhe gjithashtu edhe muaji maj do të paguhet në vlerë të dyfishtë. Totali i pagesës shtesë për këto skema i paguar deri më tani është 5,181,034 euro:

Muaji I pagesës	Numri I familjeve	Numri I anëtarëve	Totali I paguar shtesë për muaj
Mars	24,198	98,070	€ 2,555,520
Prill	24,697	100,060	€ 2,625,514
			€ 5,181,034

Përveç familjeve me asistencë sociale, përmes pakos është siguruar një shtesë edhe për përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë deri në 100 euro. Për çdo

përfitues të këtyre skemave përmes pakos është siguruar edhe një shtesë në vlerë 30 euro për muajt prill, maj dhe qershor.

Gjithsej nga kjo masë kanë përfituruar 162,687 persona, në vlerë totale 4,880,610 euro. E njëjta shumë do të paguhet për këta persona edhe për muajt maj dhe qershor.

Skema përfituese	Numri i përfituesve	Shtesa për person	Totali i paguar shtesë për muaj
Pension familjar	3,356	€ 30	€ 100,680
Pension me aftësi të kufizuar	19,154	€ 30	€ 574,620
Penzion bazë	137,243	€ 30	€ 4,117,290
Pension invalidor i punës	98	€ 30	€ 2,940
Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuar	2,343	€ 30	€ 70,290
Fëmijët në strehim familjar brenda ff.	493	€ 30	€ 14,790
Total	162,687	€ 30	€ 4,880,610

Gjithashtu përmes kësaj mase, janë rikthyer në listë të përfituesve edhe personat të cilët për shkak të mos-paraqitjes apo mos-vlerësimit nuk u janë rinovuar të drejtat e tyre. Gjithsej në listë janë rikthyer 5,081 persona për të cilët pagesa në total ka arritur 573,747 euro.

Skema përfituese	Numri i përfituesve	Totali i paguar sipas masës 2 për 1 muaj
Pensioni kontributiv	186	€ 33,852
Pension me aftësi të kufizuar	3,574	€ 375,270
Pension bazë	1,225	€ 147,000
K. Verber	96	€ 17,625
	5,081	€ 573,747

6.2. Masa 3, 7, 8, 14

Nga sektori privat, për të gjitha masat që kanë të bëjnë me shpenzimet e pagave dhe qirasë, totali i bizneseve që kanë aplikuar deri më datë 8 maj 2020 është 40,848. Ndërsa sipas numrit të përfituesve, ndarja është si më poshtë:

- 142,320 punëtorë aktiv kanë aplikuar për të përfituruar nga masa 3a, për subvencionim të pagës në vlerë të 170 euro
- 1,459 punëtorë kanë aplikuar për të përfituruar nga masa 8, për pagesë 130 euro si të larguar nga puna gjatë periudhës së pandemisë
- 11,633 punëtorë kanë aplikuar për të përfituruar nga masa 14, për pagesë 130 euro si punëtor të rinj të regjistruar me kontratë 1 vjeçare pas fillimit të pandemisë

- 15,491 punëtor të furrave, marketeve ushqimore dhe barnatoreve kanë aplikuar për të përftuar nga masa 7, për shtesë 100 euro mbi pagë për shkak të rrezikut të shtuar të infektimit
- 7,581 biznese kanë aplikuar për subvencionim të qirasë, me gjithsej 13,599 kontrata të qirasë

Sa i përket realizimit të këtyre masave, deri më datë 8 maj 2020, janë aprovuar dhe paguar subvencioni 170 euro për pagë sipas masës 3a për 80,608 punonjës. Vlera totale e pagesës e realizuar në llogari të punonjësve është 13,703,360 euro.

Përshkrimi	Totali
Numri I bizneseve që kanë aplikuar	30,911
Numri I punëtorëve që kanë aplikuar	142,320
Numri I punëtorëve që janë paguar	80,608
Vlera totale e paguar	€ 13,703,360

Të gjitha masat tjera që kanë të bëjnë me pagesat për punëtorët e sektorit privat mbetet të procesohen në ditët në vijim.

Duhet të theksohet këtu numri i lartë i punëtorëve të rinjë të regjistruar në krahasim me punëtorët e larguar nga puna gjatë periudhës së pandemisë. Numri i punëtorëve të rinjë të regjistruar është 8 herë më i lartë se ai i punëtorëve të larguar nga puna. Këto shifra tregojnë edhe një formalizim të ekonomisë pasi që dihet se një numër i madh i punëtorëve kanë punuar pa kontrata dhe u lajmëruar si punëtorë.

Përmes kësaj mase është hapur një dritare që sjellë dobi të shumëfishta si:

- Hapë mundësinë të formalizohet një pjesë e ekonomisë joformale
- Ofron mundësinë të mos mbesin pa të ardhura punëtorët që kanë qenë joformal
- Rritë sigurinë e punëtorit, duke e pajisur me kontratë një vjeçare përmes të cilës i paguhen kontributet pensionale, i sigurohet pushimi vjetor dhe të drejtat sipas ligjit të punës
- Ofron mundësinë punëdhënësit që të mbaj në punë pa shpenzime shtesë edhe punëtorët që nuk kanë qenë të lajmëruar, gjë që e bën më të lehtë edhe vazhdimin e biznesit pas fazës së pandemisë, duke zvogëluar shpenzimet e rekrutimit

Gjithashtu, përmes incentivave të krijuara nga kjo pako, është mundësuar ruajtja e vendeve të punës në masë të madhe, gjë që dëshmohet përmes numrit të ulët të punëtorëve të lajmëruar si të larguar nga puna.

6.3. Masa 6

Sa i përket sektorit publik, më 29.04.2020 është bërë ekzekutimi i pagesës së shtesës mbi pagë prej 300 euro bruto, gjegjësisht implementimi i masës 6 të Pakos; masë kjo e cila përfshin të gjithë ata punëtorë të cilët me Vendime të Qeverisë ose Ministrave kanë qenë të detyruar të punojnë në terren dhe të jenë të ekspozuar direkt ndaj rrezikut për infektim me COVID-19. Pagesa e shtesës mbi pagë është bërë për 21,518 punëtorë në vlerë total prej 6,752,119 euro. Këta 21,518 punëtorë janë të punësuarit e sektorit publik, pra mjekët, infermierët, inspektorët, zjarrfikësit, policët dhe punonjësit tjerë që kanë plotësuar kriteret sipas masës 6 të pakos.

6.4. Masa 15

Për masën e 15 janë pranuar 68,184 aplikacione, deri më datë 8 maj 2020. 19,100 prej tyre janë regjistruar dhe kontrolluar deri më datë 8 maj 2020 dhe sipas rezultateve të krahasimit të të dhënave, aplikacionet e aprovuara do të paguhen deri më 15 maj 2020.

Nga kjo masë do të përfitojnë familjet të cilat për shkak të situatës kanë mbetur pa asnjë të ardhur, në mënyrë që të sigurohemi se çdo familje së paku përfiton të ardhurat minimale për të tejkaluar situatën e emergjencës.

6.5. Masa 4

Me anë të pakos iu është ofruar mbështetje edhe ndërmarrjeve publike, të cilat për shkak të situatës së pandemisë mund të gjinden në vështirësi financiare nga mungesa e inkasimit. Sipas masës 4 këtyre ndërmarrjeve do t'u ofrohet huadhënie pa interes me kthim deri në fund të vitit 2020. Gjithsej 8 ndërmarrje publike kanë paraqitur kërkesën për hua të tillë, me vlerë totale të kërkesave që arrijnë në 18.4 milion. Megjithatë, vlera që është ndarë për këtë masë është 15 milion, që do të ndahet te kompanitë që kanë paraqitur kërkesën.

6.6. Masa 9, 11, 12, 13

Me anë të kësaj pako është siguruar mbështetje shtesë edhe për:

- komunitetin jo shumicë (2 milion euro)
- MBPZHR për rritje të granteve dhe subvencioneve për prodhimin bujqësor (5 milion euro)
- MKRS për mbështetjen e aktiviteteve sportive dhe kulturore (5 milion euro)
- MEPTINIS për mbështetjen e eksportuesve

Nga ana e MFT është dhënë udhëzimi që të filloj shfrytëzimi i këtyre shumave të ndara sipas pakos dhe secila Organizatë Buxhetore më lartë është përgjegjëse për zbatimin e këtyre masave. Përmes këtyre masave sigurohet përmirësimi i kushteve të jetesës së komuniteteve jo shumicë që edhe ashtu jetojnë në kushte më të rënda; sigurohet rifillimi i aktiviteteve sportive dhe kulturore që janë ndërprerë tërësisht si rezultat i pandemisë, si dhe krijohet incentivë për rritjen e prodhimit dhe eksporteve, njëkohësisht ruajtjen e vendeve të punës.

7. Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike

Më 6 maj 2020 u formua grupi punues për Pakon e Rimëkëmbjes ekonomike. Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike është vazhdimësi e masave të marra përmes Pakos Fiskale Emergjente në përpjekje për t'i dalë në ndihmë sektorit privat të prekur rëndë nga situata e pandemisë por edhe amvisërive.

Grupi punues i kësaj pako kryesohet nga Zëvendës Ministri i Financave dhe Transfereve, Ilir Aliu, ndërsa anëtarët janë përfaqësues të të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kësaj pako, si dhe përfaqësues të sektorit privat.

Në mënyrë që kjo pako të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe të adresoj të gjitha nevojat e ekonomisë gjatë periudhës së rimëkëmbjes, janë përfshirë jo vetëm përfaqësues të ministrive përkatëse, por edhe Banka Qendrore e Kosovës, Fondi Kosovar për Garanci Kreditor, përfaqësues të bizneseve në Kosovë si dhe ekspert të pavarur ligjor dhe të ekonomisë.

Megjithëse kjo pako ende nuk është finalizuar, është e qartë se vlera e saj do të jetë shumëfish më e madhe se pakoja e parë dhe kryesisht do të fokusohet në:

- Rritjen e prodhimit dhe eksporteve
- Mbështetjen e start-up bizneseve
- Mbështetjen e bizneseve me pronaret gra
- Mbështetjen e produkteve vendore, në vecanti ato bujqësore
- Mbështetja e bizneseve që merren me IT
- Mbështetja e kompanive “Green Energy”
- Mbështetja e industrisë së hotelerisë dhe turizmit
- Sigurimi i likuiditetit afatshkurtër për amvisëritë

Këto do të arrihen kryesisht përmes rritjes së garantimit të kredive dhe subvencionimit të pjesëshëm apo të plotë të interesit.